

20152155920

## L I G J PËR ZEJTARI

### I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

#### Neni 1

Me këtë ligj rregullohen kushtet për kryerjen e veprimtarisë zejtare dhe për lëshimin e lejes për zejtar, mbajtja e Regjistrit të zejtarëve, organizimi i punës të çirakut, si dhe organizimi dhe financimi i sistemit të odave.

#### Neni 2

Shprehje të caktuara të përdorura në këtë ligj, e kanë domethënien si vijon:

1. "Zejtar" është person fizik i cili kryen punë zejtare dhe është i regjistruar në Regjistrin e zejtarëve;
2. "Kryerës i veprimtarisë zejtare" është zejtar, tregtar individ shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar nga një person, që kryen veprimtari zejtare;
3. "Regjistër i zejtarëve" është libër publik i cili paraqet bazën e të dhënave për të gjithë kryerësit e veprimtarisë zejtare të regjistruar të cilin e mban Oda e Zeytarëve të Republikës së Maqedonisë;
4. "Oda e Zeytarëve" është oda rajonale e zeytarëve , oda komunale e zeytarëve dhe Oda e Zeytarëve Shkup të cilat kryejnë autorizime publike në pajtim me ligjin;
5. "Leje për zeytar" është dokument publik i cili i lëshohet kryerësit të veprimtarisë zeytare në bazë të aftësisimit profesional përkatës ose arsimit profesional për veprimtarinë;
6. "Regjistrues" është person i autorizuar i cili kryen regjistrimet në Regjistrin e Zeytarëve sipas procedurës të përcaktuar me këtë ligj;
7. "Autorizim publik" është autorizim i cili i ndahet odës së zeytarëve në pajtim me këtë ligj për lëshimin e akteve si vijon:
  - aktvendim për regjistrim në Regjistrin e zeytarëve,
  - aktvendim për refuzimin e kërkesës për regjistrim në Regjistrin e zeytarëve,
  - leje për zeytar,
  - aktvendim për regjistrimin e ndryshimit,
  - aktvendim për ndërprerjen e përkohshme të kryerjes së veprimtarisë,
  - aktvendim për çlajmërimin e veprimtarisë dhe
  - aktvendim për kryerjen e përkohshme të veprimtarisë zeytare;
8. "Veprimtari zeytare" është prodhim zeytar, shërbime zeytare dhe veprimtari e zeytarisë vendase dhe artistike;
9. "Prodhim zeytar" është përpunimi dhe prodhimi i produkteve kryesisht me porosi, në seri të vogla, i cili nuk ka karakteristika të prodhimit industrial;
10. "Shërbime zeytare" janë ndreqje dhe mirëmbajtje e prodhimeve, pajisjeve dhe objekteve, si dhe kryerja e shërbimeve personale;
11. "Veprimtari të zeytarisë vendase dhe artistike" është veprimtari për të cilën është karakteristik mënyra e thjeshtë e punës kryesisht me punë dore, artistike dhe krijim të disenjatorit dhe
12. "Sistem njësportel" është sistem i cili mundëson pranim, përpunim, shpërndarje të të dhënave dhe dokumenteve të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë zeytare.

### Neni 3

Në procedurën gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese do të zbatohen dispozitat e Ligjit për mbikëqyrje inspektuese dhe Ligjit për inspektoratin shtetëror të tregut, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

## II. KRYERJA E VEPRIMTARISË

### Kushte

#### Neni 4

Veprimtaria zejtare është veprimtari prodhuese ose shërbyese për të cilën vlejné karakteristikat në vijim:

- prodhim ose shërbime në bazë të porosive individuale;
- prodhim në seri të vogla ku prodhimi serik nuk është pjesë dërrmuese e veprimtarisë dhe
- kryhet me shfrytëzimin e makinave, veglave dhe pajisjeve teknike adekuate për veprimtarinë në pajtim me alinenë paraprake dhe nuk kanë veçori të procesit të automatizuar të punës.

#### Neni 5

Regjistër kompetent për regjistrimin e zejtarit është Regjistri i zejtarëve të cilin e mban Oda e Zejtarëve të Republikës së Maqedonisë në mënyrë elektronike si regjistër qendror dhe oda e zejtarëve si trup themelor regjistrues.

Regjistrin qendror për regjistrimin e tregtarit individ, shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar e themeluar nga një person është regjistri tregtar të cilin e mban Regjistri Qendror.

#### Neni 6

Këshilli i komunës, respektivisht Këshilli i qytetit të Shkupit, e përcakton orarin e punës së veprimtarive zejtare varësisht nga traditat e vendit dhe nevojat.

#### Neni 7

Zejtari përgjigjet për obligimet e veta me tërë pronën e vet.

#### Neni 8

Kryerësi i veprimtarisë zejtare në pajtim me këtë ligj mund të kryejë:

- një ose më shumë veprimtari të ngjashme zejtare dhe
- shitjen e prodhimeve të veta.

Kryerësi i veprimtarisë zejtare mundet gjatë kryerjes së veprimtarisë të kryejë shitjen e prodhimeve tjera të cilat shërbejnë për prodhimin ose shërbimin e tij.

Kryerësi i veprimtarisë zejtare mundet prodhimet e veta t'i shesë në hapësirat në të cilat e kryen veprimtarinë ose në vendet e përcaktuara për atë dedikim nga Këshilli i komunës ose nga Këshilli i qytetit të Shkupit.

## III. REGJISTRI I ZEJTARËVE

#### Neni 9

Regjistri i zejtarëve është regjistër i vetëm në territorin e Republikës së Maqedonisë.

Oda e Zejtarëve të Republikës së Maqedonisë dhe oda e zejtarëve janë kompetent për mbajtjen e integritetit të të dhënave të Regjistrit të zejtarëve, sigurimi i nivelit adekuat të mbrojtjes dhe qasjes në të dhënat, ruajtja, mbikëqyrja dhe mirëmbajtja e sistemit për përpunimin

e të dhënave, ruajtja, mbikëqyrja dhe mirëmbajtja e rrjetit për dhënien në shfrytëzim të të dhënave, sigurimi i qasjes të dhënave në regjistër, disenjimi i mbikëqyrjes së performancave të regjistrit dhe zbatimi i standardeve për përdorimin dhe sigurinë e të dhënave në regjistër.

Të dhënat personale të Regjistrit të zejtarëve ruhen përgjithmonë.

Formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së Regjistrit të zejtarëve e përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e zejtarisë.

#### Neni 10

Regjistrimin në Regjistrin e zejtarëve e kryen regjistruesi i Odës së Zejtarëve.

Regjistruesin e përcakton këshilli drejtues i odës së zejtarëve me propozim të kryetarit të odës së zejtarëve.

Në komunën ku nuk është themeluar oda e zejtarëve regjistrimi në Regjistrin e zejtarëve e kryen oda më afërt e zejtarëve në pajtim me autorizimin e ndarë publik nga ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e zejtarisë.

#### Neni 11

Oda e Zejtarëve të Republikës së Maqedonisë përmes ueb servisit të vendosur me Regjistrin qendror pa kompensim ndërmerr të dhëna për regjistrim për themelimin, ndryshimin dhe shlyerjen e tregtarit individ, shoqatës me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqatës me përgjegjësi të kufizuar e themeluar nga një person, në pajtim me Ligjin për Regjistrin Qendror, dhe në bazë të marrëveshjes së lidhur paraprakisht ndërmjet dy subjekteve.

Oda e Zejtarëve të Republikës së Maqedonisë në afat prej tri ditë pune në mënyrë elektronike e njofton odën e zejtarëve për regjistrimin e kryerësit të veprimtarisë zejtare në regjistrin tregtar.

Tregtari individ shoqëria me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëria me përgjegjësi të kufizuar e themeluar nga një person të cilët kryejnë veprimtari të zejtarisë për të cilët nevojitet arsim adekuat profesional janë të obliguar në afat prej 30 ditësh nga regjistrimi në regjistrin qendror të parashtrijnë kërkesë të oda e zejtarëve për marrjen e lejes së zëjtarit e cila regjistrohet në Regjistrin e zejtarëve.

Statusin e kryerësit të veprimtarisë zejtare, tregtari individ, shoqata me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqata me përgjegjësi të kufizuar nga një person për veprimtaritë e zejtarisë për të cilat nuk nevojitet aftësim profesional adekuat ose arsim profesional, e fiton me regjistrim në regjistrin tregtar.

### **Regjistrimi në Regjistrin e zejtarëve**

#### Neni 12

Për kryerjen e veprimtarisë zejtare, personi i papunësuar fizik parashtron kërkesë me shkrim te Oda e Zejtarëve për regjistrim në Regjistrin e zejtarëve, në vendin ku gjenden hapësirat ku kryhet veprimtaria zejtare. Nëse në vendin ku gjenden hapësirat ku kryhet veprimtaria zejtare nuk është formuar oda e zejtarëve personi i papunësuar fizik parashtron kërkesë me shkrim te oda më afërt e zejtarisë nga vendi ku gjenden hapësirat ku kryhet veprimtaria zejtare.

Nëse veprimtaria zejtare kryhet pa hapësira, kërkesa për regjistrim në Regjistrin e zejtarëve parashtrohet në odën e zejtarëve që e përfshin rajonin e jetesës së personit të papunësuar fizik i cili kërkon regjistrim në Regjistrin e zejtarëve. Nëse në vendin e jetesës së personit të papunësuar fizik nuk është formuar odë e zejtarëve për regjistrim parashtrohet te oda më afërt e zejtarëve në vendin e personit të papunësuar.

Kërkesa nga paragrafi 1 i këtij neni parashtrohet në dy formularë identikë, me një shtojcë të dëshmimeve.

Me kërkesën nga paragrafi 1 i këtij neni, personi fizik dorëzon:

- vërtetim nga Agjencia për Punësim e Republikës së Maqedonisë se është i papunësuar,

- dëshmi për plotësimin e njërës nga kushtet nga neni 35 paragrafi 1 i këtij ligji dhe
- dëshmi për kompensim të paguar për shërbimin e kryer nga autorizimet publike.

Për lëshimin e aktvendimit për regjistrim dhe leje të zejtarit paguhet kompensim.

Oda e Zejtarëve në afat prej pesë ditë pune nga dita e parashtrimit të kërkesës lëshon aktvendim për regjistrim në Regjistrin e zejtarëve dhe leje të zejtarit.

Nëse personi fizik kërkesës për regjistrim në Regjistrin e zejtarëve ia bashkëngjit dëshmitë të cilat nuk janë lëshuar nga institucione kompetente, oda e zejtarëve do të miratojë aktvendim me të cilin refuzohet kërkesa për regjistrim në Regjistrin e zejtarëve.

Formën dhe përmbajtjen e kërkesës nga paragrafi 1 i këtij neni e përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e zejtarisë.

Formën dhe përmbajtjen e vendimit për regjistrimin e lejes për zejtar i përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e zejtarisë.

Formën dhe përmbajtjen e aktvendimit për refuzimin e kërkesës për regjistrim në Regjistrin e zejtarëve e përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e zejtarisë.

Kundër aktvendimit nga paragrafi 7 i këtij neni mund të paraqitet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e zejtarisë.

### Neni 13

Me ditën e regjistrimit në Regjistrin e zejtarëve, personi fizik fiton cilësinë e zejtarit.

Nga një ekzemplar nga aktvendimi për regjistrim në Regjistrin e zejtarëve dorëzohet te Regjistri Qendror.

### Neni 14

Regjistri i zejtarëve mbahet si sistem njësportel nga ana e Odës së Zejtarëve të Republikës së Maqedonisë me çka oda e zejtarëve në emër të tyre i regjistron të dhënat për kryerjen e veprimtarisë zjettare.

### Neni 15

Përmes sistemit njësportel mundësohet:

- sigurimi i të dhënave të cilat janë të obligueshme për regjistrimin e zejtarit në Regjistrin e zejtarëve dhe
- bashkimi i të gjithë të dhënave relevante juridike në një aktvendim për realizimin e të drejtave të zejtarit.

### Neni 16

Përmes sistemit njësportel kryhet:

- dorëzimi i aktvendimit nga trupi themelor regjistruar te Regjistri Qendror dhe parashtrimi i fletëparaqitjes për regjistrim në Regjistrin Qendror,
- përgatitja dhe dorëzimi i dokumenteve për lajmërim dhe çlajmërim nga Agjencia për Punësim e Republikës së Maqedonisë, Fondi për Sigurim Pensional dhe Invalidor i Maqedonisë dhe Fondi për Sigurim Shëndetësor i Maqedonisë dhe
- përgatitja dhe dorëzimi i dokumenteve te organet kompetente në pajtim me ligjin.

Përmes sistemit njësportel mund të kryhen edhe shërbimet në vijim:

- përgatitja dhe dorëzimi i dokumenteve për xhiro llogari në bankë sipas zgjedhjes së zejtarit,
- përgatitja e vulës sipas zgjedhjes së zejtarit
- përgatitja dhe dorëzimi i kërkesës te Drejtoria për të hyra publike, për lëshimin e aktvendimit për lirim nga tatimi personal për futjen dhe shfrytëzimin e sistemit të miratuar për regjistrimin e pagesave me para në dorë në pajtim me dispozitat e Ligjit për tatim personal mbi të ardhura sipas zgjedhjes së zejtarit dhe

- përgatitja dhe dorëzimi i kërkesës për tatim paushall në Drejtorinë për të Hyra Publike sipas zgjedhjes së zëjtarit.

### **Firma**

#### **Neni 17**

Zëjtari i cili veprimtarinë e zëjtarisë e kryen në hapësira, doemos duhet të ketë firmë të vendosur në vend të dukshëm.

Rregullat që kanë të bëjnë me firmën e shoqërive tregtare në mënyrë adekuate zbatohen edhe për zëjtaret.

Zëjtari i cili për kryerjen e veprimtarisë zëjtare nuk e ka patjetër të ketë hapësira pune, nuk duhet të ketë firmë të vendosur.

#### **Neni 18**

Zëjtari në punën e vet duhet të përdorë firmë me të cilën e kryen veprimtarinë zëjtare, siç është regjistruar në Regjistrin e zëjtarëve.

Zëjtari mundet të përdorë edhe shenjë të shkurtër të firmës me të cilën e kryen veprimtarinë zëjtare e cila duhet të dallohet nga shenjat të shkurtuara të zëjtarëve të regjistruar në Regjistrin e zëjtarëve.

Shenja e shkurtër e firmës regjistrohet në Regjistrin e zëjtarëve.

### **Regjistrimi i ndryshimit**

#### **Neni 19**

Zëjtari është i obliguar për çdo ndryshim të veprimtarisë, plotësimit të veprimtarisë dhe ndryshim të adresës së selisë të parashtrijë kërkesë për regjistrimin e ndryshimit në Regjistrin e zëjtarëve.

Oda e Zëjtarëve në afat prej pesë ditë pune lëshon aktvendim për regjistrim të ndryshimit.

Formën dhe përmbajtjen e kërkesës për regjistrimin e ndryshimit në Regjistrin e zëjtarëve e përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e zëjtarisë.

Formën dhe përmbajtjen e aktvendimit për regjistrimin e ndryshimit në Regjistrin e zëjtarëve e përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e zëjtarisë.

### **Selia**

#### **Neni 20**

Zëjtari mund ta kryejnë veprimtarinë në një ose më shumë hapësira kurse për seli të zëjtarit do të jetë ajo hapësirë e cila është regjistruar në Regjistrin Qendror.

Nëse për kryerjen e veprimtarisë nuk janë të nevojshme, nëse selia vendoset vendi ku zëjtari ka vendbanim.

Kryerësi i veprimtarisë zëjtare nuk mund ta kryejë veprimtarinë jashtë nga hapësirat për punë për këto veprimtari zëjtare të cilat detyrimisht kryhen në hapësira.

Kryerësi i veprimtarisë zëjtare mund veprimtarinë zëjtare ose punë të caktuara nga ajo veprimtari t'i kryejë jashtë nga hapësirat, si dhe jashtë nga selia e vet në varshmëri nga lloji dhe mënyra e kryerjes së shërbimeve të veprimtarisë zëjtare ose nëse ashtu është marrë vesh me porositesin e shërbimit.

Veprimtaritë zëjtare të cilat detyrimisht duhet të kryen në hapësira do t'i përcaktojë ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore për punë nga sfera e zëjtarisë.

#### Neni 21

Kryerësi i veprimtarisë zejtare është i obliguar të sigurojë që hapësirat në të cilat e kryen veprimtarinë t'i plotësojë kushtet minimale të përcaktuara teknike.

Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e zejtarisë i përcakton kushtet teknike minimale nga paragrafi 1 të këtij neni.

#### Neni 22

Kryerësi i veprimtarisë zejtare është i obliguar që plotësimin e kushteve nga neni 21 paragrafi 1 të këtij ligji ta paraqesë te Inspektorati Shtetëror i Tregut, në ditën e fillimit me kryerjen e veprimtarisë, në formular formën dhe përmbajtjen e të cilit e përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e zejtarisë.

### **Mënyra e kryerjes së veprimtarisë**

#### Neni 23

Kryerësi i veprimtarisë zejtare mund të kryejë vetëm veprimtari zejtare që janë theksuar në aktvendimin për regjistrim në regjistrin kompetent dhe lejen për zejtar.

#### Neni 24

Kryerësi i veprimtarisë zejtare nëse kjo nuk është përcaktuar me rregull tjetër është i obliguar:

- 1) në vend të dukshëm të vendosë listë të çmimeve të prodhimeve, respektivisht shërbimeve të veta;

- 2) në vend të dukshëm ta vendosë kohën e vet të punës dhe t'i përmbahet asaj dhe

- 3) të posedojë dokumentacion përkatës për mallrat e blera dhe materialet dhe për mallrat e shitura respektivisht shërbimet.

### **Ndalimi i përkohshëm**

#### Neni 25

Zejtari mund përkohësisht mund ta ndalojë kryerjen e veprimtarisë në rast të:

- 1) sëmundjes derisa zgjat paaftësia për punë;

- 2) adaptimit dhe rikonstruktimit të hapësirës për punë deri në tre muaj, një herë në vit;

- 3) shtatzënisë, lindjes dhe prindërisë;

- 4) paraburgimit, vuajtjes së dënimit me burg deri në gjashtë muaj, dënimit të shqiptuar ndalesë për kryerjen e veprimtarisë deri në gjashtë muaj dhe

- 5) vëllimit të zvogëluar të punës deri në tre muaj, dy herë në vit.

Në rast kur ndalimi i veprimtarisë zgjat më pak se 30 ditë, nuk llogaritet si ndalim i përkohshëm.

Ndalimi i përkohshëm sipas të gjitha bazave nuk mund të jetë më i gjatë se gjashtë muaj gjatë vitit me përjashtim të pikës 3 nga paragrafi 1 të këtij neni ku kohëzgjatja e ndalimit të përkohshëm të kryerjes së veprimtarisë zejtare përcaktohet në pajtim me dispozitat nga sfera e marrëdhënieve të punës.

Zejtari është i obliguar në afat prej tetë ditësh nga dita e ndodhjes së rasteve nga paragrafi 1 të këtij neni ta paraqesë ndalimin e përkohshëm të kryerjes së veprimtarisë në odën e zejtarëve.

#### Neni 26

Oda e zejtarëve e cila e ka kryer regjistrimin në Regjistrin e Zejtarëve, me kërkesë të zejtarit në afat prej pesë ditë pune lëshon aktvendim për ndalim të përkohshëm të veprimtarisë, nga i cili një ekzemplar dorëzon te Regjistri Qendror.

Formën dhe përmbajtjen e kërkesës së ndalimit të përkohshëm e përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e zejtarisë.

Formën dhe përmbajtjen e aktvendimit për ndalim të përkohshëm të veprimtarisë e përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e zejtarisë.

Kundër aktvendimit nga paragrafi 1 të këtij neni mund të parashtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve nga dita pranimit të aktvendimit te ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e zejtarisë.

Zejtari është i obliguar, nëse veprimtarinë zejtare e kryen në hapësira, në vend të dukshëm ta vendosë periudhën e ndalimit të përkohshëm të kryerjes së veprimtarisë.

#### Neni 27

Nëse zejtari fillon me kryerjen e veprimtarisë para kohës së përcaktuar me aktvendimin për ndalim të përkohshëm, është i obliguar ta paraqesë vazhdimin e kryerjes së veprimtarisë në odën e zejtarëve në afat prej tri ditësh nga ndërprerja e arsyes për të cilën ka ndodhur ndalimi i përkohshëm për kryerjen e veprimtarisë.

Oda e zejtarëve në afat prej pesë ditë pune nga dita e marrjes së fletëparaqitjes nga paragrafi 1 të këtij neni e njofton Regjistrin Qendror për vazhdimin e kryerjes së veprimtarisë.

### **Ndërprerja e veprimtarisë**

#### Neni 28

Zejtari pushon ta kryejë veprimtarinë dhe shlyhet nga Regjistri i zejtarëve:

- 1) me çlajmërim,
- 2) me fuqi të ligjit dhe
- 3) në rast të vdekjes.

#### Neni 29

Për çlajmërim të veprimtarisë Së zejtarit me çlajmërim, Oda e Zejtarëve në afat prej pesë ditë pune miraton aktvendim për çlajmërim në bazë të kërkesës me shkrim të zejtarit.

Kundër aktvendimit nga paragrafi 1 të këtij neni mund të parashtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit te ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e zejtarisë.

Nga një ekzemplar nga aktvendimi i paragrafit 1 të këtij neni dorëzohet deri te Regjistri Qendror. Si ditë e ndërprerjes së kryerjes së veprimtarisë llogaritet dita e parashtrimit të kërkesës.

Aktvendimin nga paragrafi 1 i këtij neni Oda e Zejtarëve e regjistron në Regjistrin e zejtarëve nga dita e parashtrimit të kërkesës për çlajmërim të veprimtarisë.

Formën dhe përmbajtjen e kërkesës për çlajmërim të veprimtarisë e përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e zejtarisë.

Formën dhe përmbajtjen e aktvendimit për çlajmërim të veprimtarisë e përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e zejtarisë.

#### Neni 30

Zejtari pushon ta kryejë veprimtarinë me fuqi të ligjit në rastet në vijim:

- 1) nëse pensionohet;
- 2) nëse është në vuajtje të dënimit me burg në kohëzgjatje më gjatë se gjashtë muaj dhe
- 3) me vendim të plotfuqishëm gjyqësor ose aktvendim të plotfuqishëm i shqiptohet masë për siguri ndalim për kryerjen e veprimtarisë më gjatë se gjashtë muaj.

Për ndërprerje të veprimtarisë me fuqi të ligjit, Oda e Zejtarëve miraton aktvendim për shlyerje në Regjistrin e zejtarëve me ditën e plotësimit të kushtit nga paragrafi 1 të këtij neni.

Kundër aktvendimit nga paragrafi 2 të këtij neni mund të parashtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve nga dita pranimit të vendimi përmes Odës së Zejtarëve deri te ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e zejtarisë.

Aktvendimin nga paragrafi 2 të këtij neni Oda e Zejtarëve e regjistron në Regjistrin e zejtarëve.

Nga një ekzemplar nga aktvendimi i paragrafit 1 të këtij neni dorëzohet te Regjistri Qendror. Si ditë e ndërprerjes së kryerjes së veprimtarisë llogaritet dita e parashtrimit të kërkesës.

#### Neni 31

Zejtari mund t'ia bartë kryerjen e veprimtarisë anëtarit të familjes së tij më të ngushtë, si dhe personave të tretë me marrjen e të gjitha të drejtave dhe obligimeve, për çka parashtron kërkesë te oda e zejtarëve.

Anëtari i familjes më të ngushtë respektivisht personi i tretë është i obliguar në afat prej 30 ditëve nga dita e regjistrimit në Regjistrin e zejtarëve të dorëzojë prova në pajtim me nenin 35 paragrafi 1 të këtij ligji.

Nëse provat nga neni 35 paragrafi 1 të këtij ligji nuk dorëzohen në afatin e përcaktuar nga paragrafi 2 të këtij neni, oda e zejtarëve miraton aktvendim për shlyerjen e regjistrimit në Regjistrin e Zejtarit.

Kundër aktvendimit për shlyerje nga Regjistri i Zejtarëve mund të parashtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve nga dita pranimit të vendimi përmes odës së zejtarëve te ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e zejtarisë.

#### Neni 32

Në rast të vdekjes së zejtarit, veprimtarinë me përjashtim të veprimtarive zejtare, të cilat kanë të bëjnë me prodhimin e prodhimeve ushqimore dhe pijeve, si dhe prodhimeve për shëndet dhe kurim të trupit, mund të vazhdojë ta kryejë bashkëshorti ose trashëgimtari nga rendi i parë i trashëgimisë më së gjati deri një vit.

Bashkëshorti ose trashëgimtari nga rendi i parë i trashëgimisë në afat prej 30 ditëve nga dita e vdekjes së zejtarit parashtron kërkesë deri te Oda e Zejtarëve për marrjen e aktvendimit për kryerjen e përkohshme të veprimtarisë zejtare, për periudhën e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni.

Oda e Zejtarëve në afat prej pesë ditë pune lëshon aktvendim për kryerje të përkohshme të veprimtarisë së zejtarit.

Kundër aktvendimit nga paragrafi 3 të këtij neni mund të parashtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve nga dita pranimit te ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e zejtarisë.

Nëse Oda e Zejtarëve miraton aktvendim me të cilën bartet kryerja e veprimtarisë anëtarit nga familja më e ngushtë e zejtarit, si dhe personit të tretë me marrjen e të gjitha të drejtave dhe obligimeve, ekzemplar nga i njëjti dorëzohet te Regjistri Qendror.

Formën dhe përmbajtjen e kërkesës për lëshimin e aktvendimit për kryerje të përkohshme të veprimtarisë e përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e zejtarisë.

Formën dhe përmbajtjen e aktvendimit për kryerje të përkohshme të veprimtarisë e përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e zejtarisë.

#### Neni 33

Oda e Zejtarëve do ta shpallë aktvendimin për kryerjen e përkohshme të veprimtarisë së zejtarit si të pavlefshëm nëse në mënyrë plotësuese konstaton se zejtari e ka marrë aktvendimin për regjistrim në regjistrin e zejtarëve në bazë të provave të rrejshme dhe do ta shlyejë nga Regjistri i zejtarëve.

#### Neni 34

Ministria kompetente për punët nga sfera e zejtarisë në bashkëpunim dhe Odën e Zejtarëve të Republikës së Maqedonisë përgatit Listë të zejeve të cilat janë në zhdukje në bazë të kritereve në vijim:

- veprimtari zeytare tradicionale autentike për nënqiellin e Republikës së Maqedonisë,
- veprimtaria zeytare tradicionale për të cilat zvogëlohet interesi për regjistrim në dhjetë vitet e fundit përkatësisht me përqindje më të vogël për rigjenerim dhe
- veprimtari zeytare të cilat realizojnë të hyra të vogla në vazhdimësi.

Lista e zejeve në zhdukje publikohet në ueb faqen e Ministrisë kompetente nga sfera e zejtarisë dhe në ueb faqen e Odës së Zejtarëve të Republikës së Maqedonisë.

### IV. LEJA PËR ZEJTAR

#### **Kushte për lëshimin e lejes për zeytar**

#### Neni 35

Zeytari merr me leje për zeytar nëse i plotëson një nga këto kushte:

- arsim i mesëm profesional nga drejtimi adekuat (arsim trevjeçar dhe katërvjeçar),
- kualifikim adekuat,
- aftësim profesional (arsim njëvjeçar dhe dyvjeçar),
- provim për mjeshtër,
- përvojë pune përkatëse me minimum arsim fillor nëse pesë vjet ka kryer veprimtari nga lista e veprimtarive të zejtarisë si pronar apo i punësuar tek kryerësi i veprimtarisë zeytare në veprimtari adekuate,
- përvojë pune përkatëse me minimum arsim fillor nëse tre vjet ka kryer veprimtari nga lista e veprimtarive të zejtarisë si pronar apo i punësuar tek kryerësi i veprimtarisë zeytare në veprimtari adekuate dhe
- përvojë pune përkatëse me minimum arsim të lartë ose sipëror nëse tri vjet ka kryer veprimtari nga lista e veprimtarive të zejtarisë si pronar apo i punësuar tek kryerësi i veprimtarisë zeytare në veprimtari adekuate.

Zeytari nga paragrafi 1 alinetë 5, 6 dhe 7 të këtij neni për marrjen e lejes për zeytar jep provim për kontroll të njohurive në odën e zeytarëve sipas programit të miratuar nga Oda e Zejtarëve e Republikës së Maqedonisë.

Provimin nga paragrafi 3 i këtij neni e zbaton Komisioni i formuar nga ana e odës së zeytarëve, në përbërje prej një anëtari nga oda e zeytarëve dhe dy anëtarë-kryerës të veprimtarisë zeytare përkatësisht mjeshtër të cilët kryejnë veprimtari të njëjtë apo të ngjashme për të cilën personi fizik kërkon leje të zeytarit.

Për provimin e zbatuar Komisioni nga paragrafi 4 zeytarit i jep vërtetim për provimin e dhënë për kontroll të njohurisë.

Zeytari i cili merret me veprimtari të zejtarisë vendase dhe artistike nuk duhet t'i plotësojë kushtet nga paragrafi 1 i këtij neni.

Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e zejtarisë do t'i caktojë veprimtaritë e zejtarisë për kryerjen e të cilave nuk është i nevojshëm arsim profesional adekuat apo aftësim profesional adekuat.

Veprimtaritë të cilat mund t'i kryejnë kryerësit e veprimtarisë zeytare si dhe veprimtaritë nga neni 2 paragrafi 1 pika 11 nga ky ligj ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e zejtarisë i përcakton në listë e cila botohet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

#### Neni 36

Tregtari individ, shoqëria me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëria me përgjegjësi të kufizuar e themeluar nga një person merr leje të zeztarit nëse së paku një person i punësuar plotëson një nga kushtet e nenit 35 paragrafi 1 të këtij ligji.

Tregtari individ, shoqëria me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëria me përgjegjësi të kufizuar e themeluar nga një person të cilët kryejnë veprimtari të zeztarisë mund të kenë më shumë persona të cilët i plotësojnë kushtet për marrjen e lejes për zeztar.

#### Neni 37

Nëse personi i punësuar tek kryerësi i veprimtarisë zeztare në mënyrë të përkohshme apo të përhershme e braktis kryerësin e veprimtarisë zeztare, i njëjti është i detyruar në afat prej 30 ditë nga dita e braktisjes të sigurojë person tjetër të punësuar i cili është bartës i veprimtarisë zeztare.

Gjatë mungesës së personit të punësuar tek kryerësi i veprimtarisë zeztare, i njëjti është i detyruar të ndërpresë kryerjen e veprimtarisë zeztare.

Oda e zeztarëve do t'ia merr lejen e zeztarit kryerësit të veprimtarisë zeztare nëse në afatin e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, nuk siguron person tjetër të punësuar i cili i plotëson kushtet dhe do ta shlyejë nga Regjistri i zeztarëve.

#### Neni 38

Oda e zeztarëve është e detyruar t'ia lëshojë lejen e zeztarisë tregtarit individ, shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar e themeluar nga një person në afat prej pesë ditë pune nga dita e parashtrimit të kërkesës për lëshimin e lejes për zeztar.

Me kërkesën nga paragrafi 1 i këtij neni tregtari individ, shoqëria me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëria me përgjegjësi të kufizuar e themeluar nga një person i bashkëngjit edhe provat nga neni 35 paragrafi 1 i këtij ligji.

Kundër aktvendimit për lëshimin e lejes për zeztar përkatësisht aktvendimit për refuzimin e lëshimit të lejes për zeztar mund të parashtrohet ankesë në afat prej 15 ditë nga dita e pranimit të aktvendimit nëpërmjet odës së zeztarëve te ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e zeztarisë.

#### Neni 39

Leja e zeztarit nuk guxon t'i bartet kryerësit tjetër të veprimtarisë zeztare.

Kryerësi i veprimtarisë zeztare mund të kryejë vetëm veprimtari zeztare që janë cekur në lejen e për zeztar, përveç në rastet kur me ligj është caktuar se mund të kryejë edhe veprimtari tjera.

#### Neni 40

Leja e zeztarit që i është dhënë tregtarit individ, shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar e themeluar nga një person shfuqizohet:

- me fuqinë e ligjit dhe
- me kërkesë të kryerësit të veprimtarisë zeztare.

Tregtarit individ, shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar e themeluar nga një person me ditën e ndërprerjes së veprimtarisë zeztare i shfuqizohet leja e zeztarit.

### V. SUBVENCIONIMI I KRYERËSVE TË VEPRIMTARISË ZEJTARE

#### Neni 41

Për zhvillim më të shpejtë të zeztarisë si dhe rritje të konkurrencës dhe inovacionit të prodhimeve dhe shërbimeve të zeztarisë, në Programin për konkurrencë, inovacione dhe sipërmarrësi, të miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë parashihen masa, aktivitete dhe mjete për mbështetjen dhe zhvillimin e zeztarisë.

## VI. TITULLI I MJESHTRIT

### Neni 42

Zejtaret mund të marrin titullin mjeshtër.

Titullin mjeshtër mund ta fitojnë edhe persona fizik të cilët janë të punësuar tek kryerësi i veprimtarisë zeytare.

Titulli mjeshtër fitohet në pajtim me Ligjin për arsim dhe trajnim profesional.

## VII. ORGANIZIMI I PUNËS SË ÇIRAKUT

### Çirakët

### Neni 43

Puna e çirakut është periudha të cilën personi i papunësuar e kalon në vendin e punës tek kryerësi i veprimtarisë zeytare me qëllim që të fiton shkathtësi, kompetenca dhe njohuri për mësimin e zejtes së caktuar.

### **Kushtet dhe mënyra e punës së çirakut**

### Neni 44

Çirak në pajtim me këtë ligj, mund të jetë personi i cili ka së paku 15 vjet dhe i cili është i papunësuar.

### Neni 45

Angazhimi i çirakëve bëhet nga ana e kryerësit të veprimtarisë zeytare apo në bazë të konkursit publik të shpallur nga ana e Agjencisë për Punësim të Republikës së Maqedonisë, nëse e njëjta është paraparë në planin operativ vjetor për programe dhe masa aktive për punësim.

### Neni 46

Puna e çirakut mund të zgjasë jo më shumë se 12 muaj.

Punëdhënësi gjatë vitit mund të angazhojë jo më shumë se dy çirakë.

Për punën e çirakut lidhet marrëveshje.

Marrëveshja për çirak është dypalëshi në rastet kur lidhet ndërmjet kryerësit të veprimtarisë zeytare dhe çirakut apo trepalëshe në rast kur është lidhur ndërmjet Agjencisë për punësim të Republikës së Maqedonisë kryerësit të veprimtarisë zeytare dhe çirakut nëse e njëjta është paraparë në planin operativ vjetor për programe aktive dhe masa për punësim.

Kryerësi i veprimtarisë zeytare është i detyruar në afat prej pesë ditë pune të dorëzojë te Agjencia për punësim e Republikës së Maqedonisë dhe te Inspektorati Shtetëror për Punë njoftim me shkrim për marrëveshjen e lidhur për punë të çirakut.

### **Të drejta dhe obligime të çirakut dhe kryerësit të veprimtarisë zeytare**

### Neni 47

Çiraku ka të drejtë:

- në formë të shkruar ta merr përshkrimin e të drejtave dhe obligimeve,
- të njihet me kushtet për punë dhe rreziqet e lidhura gjatë punës së çirakut,
- të njihet me punët dhe detyrat punuese në vendin e punës ku do të punojë si çirak dhe e realizon punën e çirakut,
- të shfrytëzojë mjete për mbrojtje gjatë punës në pajtim me rregullat për mbrojtje gjatë punës,
- për mungesë gjatë punës së çirakut, nëse për atë ekzistojnë shkaqe të arsyeshme,

- për pushim ditor dhe javor,
- për kompensim mujor në lartësi jo më të vogël se 15% nga bruto rroga mesatare e paguar në Republikën në vitin paraprak dhe
- për mbrojtje të privatësisë dhe të dhënave personale.

Mjetet për pagimin e kompensimit mujor nga paragrafi 1 alineja 8 të këtij neni sigurohen nga ana e kryerësit të veprimtarisë zeytare, Buxhetit të Republikës së Maqedonisë nëpërmjet planit operativ për programe aktive dhe masave për punësim të Agjencisë për Punësim të Republikës së Maqedonisë, projekte dhe burime tjera.

#### Neni 48

Çiraku është i detyruar:

- ta njoftojë kryerësin e veprimtarisë zeytare për sëmundjen apo shkaqet tjera për mungesë,
- të kryejë punë sipas zezes për të cilin është nënshkruar marrëveshja për çirak në pajtim me këtë ligj dhe marrëveshjen për punë të çirakut dhe aktet e përgjithshme të punëdhënësit për të cilat paraprakisht është i njoftuar;
- t'i kryejë punët personalisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë,
- t'i ruajë të dhënat e besueshme, të dhënat personale përkatësisht informatat e klasifikuara me të cilat është njoftuar dhe
- ta njoftojë punëdhënësin për pasoja të dëmshme për të cilat është njoftuar të cilat mund të ndodhin për kryerësin e veprimtarisë zeytare dhe për vetveten apo për persona të tretë.

Nëse çiraku paraprakisht e ka njoftuar kryerësin e veprimtarisë zeytare për pasojat e dëmshme në lidhje me paragrafin 1 alineja 5 të këtij neni, i njëjti nuk ka përgjegjësi për dëmin e bërë.

#### Neni 49

Çiraku i cili gjatë punës me qëllim apo nga pakujdesia do të shkaktojë dëm, është i detyruar t'ia kompensojë dëmin kryerësit të veprimtarisë zeytare, në pajtim me dispozitat nga Ligji për marrëdhëniet obliguese.

Kryerësi i veprimtarisë zeytare është i detyruar t'ia kompensojë dëmin çirakut të shkaktuar gjatë apo në lidhje me punën e çirakut, në pajtim me dispozitat nga Ligji për marrëdhëniet obliguese.

#### Neni 50

Kryerësi i veprimtarisë zeytare është i obliguar të:

- kryejë seleksionimin e kandidatëve të paraqitur për çirakë,
- sigurojë mentor për mbikëqyrjen dhe trajnimin e çirakut,
- t'i lëshojë vërtetim çirakut për punën e kryer të çirakut,
- sigurojë materiale dhe mjete për punën e çirakut,
- sigurojë pagim në kohë të kompensimit në pajtim me nenin 47 paragrafin 1 pikën 7 të këtij ligji,
- sigurojë mbrojtje për të dhënat personale dhe privatësinë dhe
- të garantojë sigurim nga sëmundjet profesionale dhe lëndimi në punë gjatë orarit të punës së çirakut, në pajtim me dispozitat për sigurim pensional dhe invalidor dhe dispozitat për sigurim shëndetësor, nëse me ligj tjetër nuk është rregulluar ndryshe.

Mjetet për sigurim nga sëmundjet profesionale dhe lëndimi në punë gjatë orarit të punës së çirakut nga paragrafi 1, alineja 7 të këtij neni sigurohen nga kryerësi i veprimtarisë zeytare.

#### Neni 51

Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë është e obliguar të ndërmjetësojë ndërmjet punëdhënësit dhe çirakut në rastet kur mjetet për pagim të kompensimit mujor sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë mban evidencë për çirakët e përfshirë në punën e çirakut.

Formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së evidencës nga paragrafi 2 i këtij neni e përcakton ministri i Punës dhe Politikës Sociale.

#### Neni 52

Marrëveshja për punë të çirakut në veçanti i përmban këto elemente:

1. Palët kontraktuese:

- punëdhënësin (emri dhe selia),
- çirakun (emri dhe mbiemri, adresa dhe vendbanimi, përkatësisht vendqëndrimi),

2. Lëndën e marrëveshjes, zanatin për të cilin do të jetë çirak,

3. Vendin e punës për të cilin do të jetë çirak,

4. Të drejtat e veçanta dhe obligimet,

5. Mënyrën e ndërprerjes dhe prishjes së marrëveshjes për punë të çirakut,

6. Orarin e punës dhe orët e punës,

7. Datën dhe vendin e lidhjes së marrëveshjes dhe

8. Afatin e vlefshmërisë.

#### Neni 53

Marrëveshja e çirakut ndërpritet:

- me kalimin e afatit kohor për të cilin është lidhur marrëveshja ose janë plotësuar kushtet për të cilat ajo është lidhur,

- me prishjen kontraktuese dhe

- kur punëdhënësi e ndërpret punën pa trashëgimtar juridik.

Çiraku mund ta prishë marrëveshjen para se t'i kalojë koha për të cilën është lidhur, me deklaratë me shkrim pa obligim për të theksuar shkakun për prishjen e marrëveshjes, përpos në rast kur prishja e marrëveshjes mund të shkaktojë pasoja të dëmshme në punën e punëdhënësit ose të personave të tretë.

Punëdhënësi mund ta prish marrëveshjen për çirakë:

- me ndërprerjen e nevojës për punë të çirakut,

- kur nuk ka mundësi t'i sigurojë kushtet për punë të çirakut dhe

- kur do të konstatojë se çiraku nuk i plotëson obligimet e kontraktuara.

Çiraku ose kryerësi i veprimtarisë zeytare për prishjen e marrëveshjes për punë të çirakut është i obliguar të parashtojë deklaratë me shkrim te pala tjetër kontraktuese në afat prej pesë ditë pune.

#### Neni 54

Me lidhjen e marrëveshjes për punë të çirakut, nuk humben të drejtat në bazë të papunësisë në pajtim me dispozitat për punësim dhe sigurim në rast të papunësisë.

Pas përfundimit të punës së çirakut, çiraku ka të drejtë të japë provim dhe të marrë diplomë për zanatin e mësuar.

Provimin për kontrollin e njohurive të çirakut e mban Komisioni i formuar nga Oda e Zejtarëve.

Komisioni ka tre anëtarë prej të cilëve njëri nga radhët e shërbimit profesional të Odës së Zejtarëve, mentori ku çiraku e ka kryer punën dhe një kryerës nga veprimtaria zeytare i cili kryen punë të njëjtë ose veprimtari të njëjtë për të cilën çiraku jep provimin.

Diplomën për punën e kryer me sukses të çirakut e lëshon Oda e Zejtarëve nëse Komisioni i formuar nga Oda e Zejtarëve konstaton se çiraku me sukses e ka kryer punën e çirakut.

## IX. SISTEMI I ODËS

### Oda e Zejtarëve e Republikës së Maqedonisë

#### Neni 55

Oda e Zejtarëve e Republikës së Maqedonisë është e pavarur, organizatë profesionale afariste e cila kryen autorizime të përcaktuara me këtë ligj dhe vepron në territorin e Republikës së Maqedonisë dhe ka cilësinë e personit juridik. Në Odën e Zejtarëve të Republikës së Maqedonisë janë anëtarë përfaqësuesit e odave të zejtarëve dhe përfaqësuesit e shoqatave profesionale në nivel të Republikës së Maqedonisë.

#### Neni 56

Oda e Zejtarëve e Republikës së Maqedonisë i kryen këto punë:

1. avancimin dhe zhvillimin e zejtarisë;
2. e shqyrton problematikën në sferën e zejtarisë dhe kujdeset për harmonizimin e tij të harmonizuar;
3. jep propozime te organet kompetente shtetërore për përmirësimin e politikave ekonomike në sferën e zejtarisë;
4. promovimin e zejtarisë, prodhimeve zejtare dhe shërbimeve në Republikën e Maqedonisë dhe në vende të huaja;
5. përfaqësimin e interesave të kryerësve të veprimtarisë zejtare;
6. i prezanton kryerësit e veprimtarive zejtare para organeve shtetërore dhe trupave në Republikën e Maqedonisë dhe në vende të huaja;
7. jep propozime për organizimin e formave të arsimit profesional;
8. rikualifikim dhe kualifikim plotësues të zejtarëve dhe të personave tjerë;
9. dhënie të mendimit dhe propozime gjatë miratimit të dispozitave nga sfera e zejtarisë;
10. formimin e gjykatës së nderit dhe
11. kryen punë tjera të përcaktuara me ligj, si dhe me statutin e Odës së Zejtarëve të Republikës së Maqedonisë.

Oda e Zejtarëve të Republikës së Maqedonisë punon në bazë të vendimeve të miratuara nga Këshilli administrativ, kuvendi dhe organet tjera të odës.

#### Neni 57

Me Statutin e Odës së Zejtarëve të Republikës së Maqedonisë rregullohet në veçanti:

- realizimi i interesave të anëtarëve të odës,
- të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e anëtarëve,
- procedura për miratimin e statutit dhe aktet tjera të përgjithshme, puna e organeve dhe trupave të Odës së Zejtarëve të Republikës së Maqedonisë, fushëveprimi i punës së tyre, përbërja, numri i anëtarëve, mënyra e zgjedhjes dhe shkarkimi, përkatësisht kohëzgjatja e mandatit;
- mënyra e vendimmarrjes në organet dhe trupat e Odës së Zejtarëve të Republikës së Maqedonisë format e organizimit të odës, organizimi dhe obligimet e shërbimit profesional dhe drejtori i shërbimit profesional;
- përfaqësimi dhe prezantimi i Odës së Zejtarëve të Republikës së Maqedonisë sferat dhe format e bashkëpunimit me odat tjera në Republikën e Maqedonisë dhe në vendet e huaja dhe me organet e pushtetit qendror dhe lokal, përkatësisht me organizata tjera, lidhje dhe bashkësi,
- mënyra e prezantimit të delegatëve dhe të shoqërive profesionale dhe pjesëmarrja e tyre në punën e këshillit administrativ gjatë vendimmarrjes për çështje të lidhura me veprimtarinë përkatëse të cilën e prezantojnë;

- mënyra e formimit të shoqërive profesionale, fushëveprimi i punës, përbërja, organet, numri i anëtarëve, mënyra e zgjedhjes dhe shkarkimi përkatësisht kohëzgjatja e mandatit dhe

- publiku, transparenca dhe informimi për punën e Odës së Zejtarëve të Republikës së Maqedonisë burimet dhe mënyra e realizimit, grumbullimi, ndarja dhe harxhimi i mjeteve të nevojshme për punën e Odës së Zejtarëve të Republikës së Maqedonisë.

Statuti i Odës së Zejtarëve të Republikës së Maqedonisë botohet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

#### Neni 58

Me Odën Ekonomike e Republikës së Maqedonisë menaxhojnë anëtarët e e vet përmes përfaqësuesve të zgjedhur nga organet dhe trupat e Odave të Zejtarëve si dhe nga përfaqësuesit e shoqërive profesionale të organizuar në nivel të territorit të Republikës së Maqedonisë.

Organet e Odës së Zejtarëve të Republikës së Maqedonisë janë: kuvendi, këshilli drejtues, këshilli mbikëqyrës dhe kryetari.

#### Neni 59

Kuvendi i Odës së Zejtarëve të Republikës së Maqedonisë është organi më i lartë i menaxhimit, ndërsa e përbëjnë përfaqësues të anëtarëve të zgjedhur nëpërmjet odave të zejtarëve dhe shoqërive profesionale. Numri i vendeve në Kuvendin e Odës së Zejtarëve të Republikës së Maqedonisë përcaktohet me statut.

Kuvendi i Odës së Zejtarëve të Republikës së Maqedonisë i kryen këto pune:

- miraton statut,
- emërton dhe shkarkon kryetar,
- miraton vendim për shumën dhe mënyrën e pagimit të kontributit të odës,
- miraton vendim për shumën dhe mënyrën e pagimit të autorizimeve publike,
- emërton dhe shkarkon nga detyra anëtarë të këshillit drejtues dhe mbikëqyrës,
- vendos për shpalljen e zgjedhjeve dhe realizon zgjedhje për organet dhe trupat,
- miraton akte të përgjithshme për kryerjen e punëve,
- miraton vendim për kryegjënë dhe shkallët, përkatësisht mënyrat dhe afatet e pagimit dhe kontributin e odës dhe shërbime të tjera,
- miraton rregullore për punën e Gjykatës së Nderit dhe
- kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj dhe statutin e Odës së Zejtarëve në Republikën e Maqedonisë.

#### Neni 60

Këshilli Drejtues i Odës së Zejtarëve të Republikës së Maqedonisë i kryen këto punë:

- i zbaton vendimet dhe konkluzionet e kuvendit,
- përcakton propozim status dhe akte të tjera në kompetence të kuvendit,
- propozon vendime, merr qëndrime dhe jep mendime për çështje në kompetence të kuvendit,
- miraton Program për dhënien e provimit për kontroll të njohurive,
- emëron dhe shkarkon drejtorin e shërbimit profesional të odës,
- kryen punë të tjera të përcaktuara me statutin dhe
- i miraton aktet e përgjithshme për organizimin dhe punën e shërbimit profesional.

#### Neni 61

Këshilli mbikëqyrës e përcjell zbatimin e Statutit dhe aktet tjera të përgjithshme të Odës së Zejtarëve të Republikës së Maqedonisë, përcjell punën financiare dhe menaxhimin me mjetet e odës dhe kryen punë tjera të caktuara me statutin.

#### Neni 62

Kryetari i Odës së Zejtarëve të Republikës së Maqedonisë paraqet dhe përfaqëson Odën e Zejtarëve të Republikës së Maqedonisë.

Kuvendi i Odës së Zejtarëve të Republikës së Maqedonisë emëron dhe shkarkon Kryetarin e Odës së Zejtarëve të Republikës së Maqedonisë.

Për kryetar të Odës së Zejtarëve të Republikës së Maqedonisë mund të zgjidhet çdo kryerës i regjistruar i veprimtarisë zejtare i propozuar nga odat e zejtarëve.

Për Kryetar të Odës së Zejtarëve të Republikës së Maqedonisë, odat zejtare mund të kandidojnë më shumë se një kandidat.

#### Neni 63

Në suazat e Odës së Zejtarëve të Republikës së Maqedonisë themelohet dhe punon Gjyqi i nderit.

Gjyqi i nderit vendos për shkeljen e traditave pozitive afariste gjatë kryerjes së veprimtarisë zejtare, si dhe për shkeljen e statutit dhe akteve tjera të Odës së Zejtarëve të Republikës së Maqedonisë.

#### Neni 64

Oda e Zejtarëve ka shërbim profesional.

Me shërbimin profesional udhëheq drejtor.

### **Oda e Zejtarëve**

#### Neni 65

Për shkak të zhvillimit dhe avancimit të zejtarisë në nivel rajonal dhe lokal, përmirësimin e cilësisë së prodhimeve dhe shërbimeve zejtare, krijim të kuadrit për nevojat e zejtarisë, mbrojtjen, zbatimin dhe avancimin e traditave afariste në zeytari, promovim të zejtarisë në nivel lokal, mbrojtje dhe avancim i veprimtarive deficitare të zejtarisë dhe zanateve të vjetra në nivel rajonal dhe lokal, si dhe për shkak të harmonizimit dhe përfaqësimit të interesave të përbashkët në nivel lokal dhe rajonal, themelohen odat e Zejtarëve.

Kryerësi i veprimtarisë zejtare bëhet anëtar i odës së zejtarëve me ditën e regjistrimit në Regjistrin e zejtarëve dhe/ose me lëshimin e lejes për zeytar.

Anëtarësimi në odën e zejtarëve është i detyrueshëm.

Anëtarë të odës së zejtarëve janë kryerës të veprimtarisë zejtare sipas rajonit të cilin e mbulon oda e zejtarëve.

Oda e zejtarëve është organizatë e pavarur afariste-profesionale e cila kryen autorizime publike në pajtim me aktvendimin e fituar për kryerjen e autorizimeve publike, kurse vepron në rajonin e caktuar, rajonin e komunës, komunës në Qytetin e Shkupit, përkatësisht Qytetin e Shkupit dhe ka cilësi të personit juridik.

Oda e zejtarëve ka statut me të cilin përcaktohen detyrat, qëllimet, organizimi i brendshëm dhe të gjitha çështjet tjera të rëndësishme për punën e odës së zejtarëve.

Organe të odës së zejtarëve janë: kuvendi, këshilli drejtues, këshilli mbikëqyrës dhe kryetari.

Oda e zejtarëve mund të fillojë me punë pas regjistrimit të vet, në Regjistrin Qendror dhe aktvendimit të fituar të autorizimeve publike nga ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetente për punët nga sfera e zejtarisë.

Regjistri qendror e regjistron odën e zejtarëve në bazë të kërkesës së këshillit iniciues prej së paku 350 kryerësve të veprimtarisë zejtare të regjistruar në rajonin e komunës.

Odat komunale të zejtarëve mund të themelohet edhe në komunat të cilat janë të mbuluara nga odat rajonale të zejtarëve dhe Oda e Zejtarëve Shkup.

Oda komunale e zejtarëve është e obliguar në afat prej 30 ditëve nga dita e regjistrimit të dërgojë kërkesë në ministrinë kompetente për punët nga sfera e zejtarisë për fitimin e aktvendimit për kryerje të autorizimeve publike, si dhe dëshmi se janë plotësuar kushtet nga neni 69 paragrafi 1 të këtij ligji.

Oda rajonale e zejtarëve është e obliguar në afat prej 30 ditëve nga dita e regjistrimit të dorëzojë kërkesë në ministrinë kompetente për punët nga sfera e zejtarisë për fitimin e aktvendimit për kryerje të autorizimeve publike, si dhe dëshmi se janë plotësuar kushtet nga neni 69 paragrafi 1 të këtij ligji.

Me kërkesën për fitimin e autorizimit publik, oda komunale e zejtarëve parashtron procesverbal në asamblenë themeluese, ekzemplar të statutit të odës dhe vendim për emërimin e kryetarit të odës, aktvendim nga Regjistri qendror dhe dëshmi për plotësimin e kushteve për ndarjen e autorizimeve publike në pajtim me nenin 69 paragrafin 1 të këtij ligji.

Me kërkesën për fitimin e autorizimit publik, oda komunale e zejtarëve parashtron aktvendim nga Regjistri qendror dhe dëshmi për plotësimin e kushteve për ndarjen e autorizimeve publike në pajtim me nenin 69 paragrafin (1) të këtij ligji.

Në çdo komunë mund të formohet vetëm një odë komunale e zejtarëve.

Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga fusha e zejtarisë autorizimin publik nga paragrafët 11 dhe 12 të këtij neni e ndan me aktvendim të propozim të Komisionit për ndarje, heqje dhe kontroll për kryerjen e autorizimeve publike në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të kërkesës së plotë.

Nëse kërkesa nga paragrafët 11 dhe 12 të këtij neni nuk është e plotë ose përmban dëshmi jovalide, ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e zejtarisë do të miratojë aktvendim në afat prej 15 ditëve për refuzimin e kërkesës.

Oda e zejtarëve që ka marrë aktvendim për refuzimin e kërkesës humb cilësinë e personit juridik dhe shlyhet nga Regjistri qendror.

Më ditën e heqjes përkatësisht ndërprerjes së kryerjes së autorizimit publik në pajtim me nenin 71 të këtij ligji regjistrimin në Regjistrin për zejtarë e kryen oda e zejtarëve më e afërt në vendin ku gjenden lokalet në të cilat kryhet veprimtari zejtare. Nëse veprimtaria zejtare kryhet pa lokale regjistrimin në Regjistrin e zejtarëve e kryen oda e zejtarëve më e afërt e cilat mbulon rajonin e banimit të personit të papunësuar.

Formën dhe përmbajtjen e kërkesës për ndarjen e autorizimit e përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e zejtarisë.

Formën dhe përmbajtjen e aktvendimit për ndarjen e autorizimit publik si dhe formën e aktvendimit të kërkesës për ndarjen e autorizimeve publike i përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga fusha e zejtarisë.

#### Neni 66

Oda e Zejtarëve i kryen punët në vijim:

- zhvillim dhe avancim të zejtarisë në suazat e territorit të cilin e mbulon,
- mbajtje të trajnimeve për anëtarët e saj,
- propozon masa për parandalimin e konkurrencës jolojale,
- zgjidhje të kontesteve ndërmjet anëtarëve të vet,
- promovim të zejtarisë në suazat e territorit të cilin e mbulon dhe më gjerë,
- i përfaqëson interesat e anëtarëve të vet te organet e pushtetit lokal,
- mbrojtje dhe avancim të veprimtarive zejtare në deficit dhe zanatet e vjetra,
- jep propozime për organizim të formave të arsimit profesional,
- rikualifikim dhe kualifikim plotësues të zejtarëve dhe personave tjerë dhe
- detyra tjera në pajtim me këtë ligj dhe Statutin e Odës së Zejtarëve.

#### Neni 67

Me Statutin e odës së zejtarëve veçanërisht rregullohet:

- realizimi i interesave të anëtarëve të odës,
- të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e anëtarëve,
- procedura për miratimin e statutit dhe aktet tjera të përgjithshme,
- puna e organeve dhe trupave, fushëveprimi i punës së tyre, përbërja, numri i anëtarëve, mënyra e zgjedhjes dhe shkarkimit, përkatësisht kohëzgjatja e mandatit,
- mënyra e vendosjes në organet dhe trupat e odës së zejtarëve format e organizimit të odës, organizim dhe obligime të shërbimit profesional dhe drejtori i shërbimit profesional,
- përfaqësimi dhe prezantimi i odës së zejtarëve fushat dhe format e bashkëpunimit me odat tjera në Republikën e Maqedonisë,
- mënyra e formimit të strukturave të shoqatave, fushëveprimi i punës së tyre, përbërja, organe, numri i anëtarëve, mënyra e zgjedhjes dhe shkarkimit, përkatësisht kohëzgjatja e mandatit dhe
- publiku, transparenca dhe informata për punën e odës burimet dhe mënyra e realizimit, grumbullimit, ndarjes dhe shpenzimit të mjeteve të nevojshme për punën e odës së zejtarëve.

#### Neni 68

Oda e Zejtarëve në pajtim me këtë ligj, mund të fitojë autorizime publike për kryerjen e autorizimeve në vijim:

- kryerje të regjistrimeve, ndryshim dhe shlyerje në Regjistrin për zeytari në formë elektronike dhe të shkruar sipas procedurës së caktuar me këtë ligj dhe miratimin e vendimeve me kërkesa të parashtruara për regjistrim, ndryshim dhe shlyerje dhe
- lëshimin dhe marrjen e lejes për zeytari sipas procedurës së caktuar me këtë ligj.

#### Neni 69

Autorizimi publik i odës së zeytarisë mund të jepet nëse i plotëson kushtet në vijim:

- ka punësuar numër të mjaftueshëm të punëtorëve të cilët janë të autorizuar për mbajtjen e procedurës dhe detyrave tjera profesionale, në pajtim me këtë ligj, me ç'rast regjistruesi i punësuar është me minimum arsim të mesëm
- në dispozicion ka pajisje përkatëse informatike për kryerjen e detyrave të autorizimit publik, me të cilin do të sigurohet vendosje dhe qasje në të dhënat dhe në regjistrin për zeytarë, dhe që përmban së paku një kompjuter, skaner, telefon dhe lidhje interneti
- nuk ekzistojnë rrethana sipas të cilave mund të konstatohet se autorizimin publik nuk do ta ushtrojë në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe
- ka siguruar hapësirë për pajisjen për kryerjen e detyrave nga autorizimit publik. Hapësira e siguruar është së paku 30 m<sup>2</sup> në të cilën ka pjesë të veçantë për regjistrimin në Regjistrin për zeytarë dhe arkivimin e të dhënave si dhe pjesë për praninë të palëve.

Oda e zeytarëve duhet t'i plotësojë kushtet nga paragrafi 1 i këtij neni gjatë gjithë kohëzgjatjes së autorizimit publik.

#### Neni 70

Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e zeytarisë formon Komision për Ndarje, Heqje dhe Kontroll të Kryerjes së Autorizimeve Publike (në tekstin e mëtuajtshëm Komisioni).

Komisioni ka pesë anëtarë nga të cilat katër anëtarë të Ministrisë kompetente për punët nga sferat e zeytarisë dhe një përfaqësues të Odës së Zejtarëve të Republikës së Maqedonisë.

Anëtarët e Komisionit kanë mandat katërvjeçar me të drejtë të rizgjedhjes.

Anëtarët e Komisionit nuk kanë të drejtë të kompensimit.

Komisioni miraton Rregullore për punë.

## Neni 71

Komisioni i kryen punët në vijim:

- i jep propozim ministrit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e zejtarisë për ndarjen e autorizimeve publike të odës së zejtarëve

- i jep propozim ministrit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e zejtarisë për ndarjen e autorizimeve publike dhe

- kryen kontroll të kryerjes së autorizimeve publike.

Nëse Komisioni konstaton mangësi dhe parregullsi në kryerjen e autorizimeve publike do të caktojë afat për mënjanimin e tyre dhe nëse të njëjtat nuk mënjahen në afatin e paraparë, ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e zejtarisë do ta heqë autorizimin publik.

Me propozim të Komisionit, ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e zejtarisë me aktvendim e heq autorizimin publik të odës së zejtarëve nëse:

- kryen autorizimin publik në mënyrë të parregullt, joligjore dhe jo në kohë,

- nuk i përmbush kushtet nga neni 69 paragrafi 1 të këtij ligji,

- jep deklarata, të dhëna ose dokumente të pavërteta në procedurë për marrjen e autorizimeve publike ose gjatë kontrollit të përmbushjes së kushteve për marrjen e autorizimit publik,

- nuk i mënjanon mangësitë dhe parregullsitë e konstatuara pas kryerjes së mbikëqyrjes nga paragrafi 2 i këtij neni në afatin e përcaktuar për mënjanimin e tyre dhe

- është filluar procedurë e falimentimit.

Me kërkesë të odës së zejtarëve ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e zejtarisë mund që me aktvendim të konstatojë ndërprerje të kryerjes së autorizimeve publike, në afat prej 30 ditësh për ndërprerjen e kryerjes së autorizimit publik.

Kundër aktvendimit për heqjen, përkatësisht ndërprerjen e kryerjes së autorizimit publik të odës së zejtarëve nuk është lejuar ankesë, ndërsa pala e pakënaqur mund të ngrejë kontest administrativ.

Aktvendimi për heqjen, përkatësisht për ndërprerjen e kryerjes së autorizimit publik është final.

Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e zejtarisë cakton se cila nga odat më të afërta të zejtarisë do t'i kryejë autorizimet publike në rast të heqjes, përkatësisht pushimit të kryerjes së autorizimit publik.

Oda e zejtarisë të cilës i është hequr ose i ka pushuar kryerja e autorizimit publik është e detyruar që në afat prej 15 ditësh nga dita e përfundimit të aktvendimit për heqjen, përkatësisht aktvendimit për pushimin e kryerjes së autorizimit publik, Odës së zejtarëve e caktuar në pajtim me paragrafin 7 të këtij neni t'ia dorëzojë dokumentacionin e plotë në formë elektronike dhe në formë të shkruar të cilat i ka në lidhje me kryerjen e autorizimit publik.

Oda e zejtarëve të cilës i është hequr autorizimi për kryerjen e autorizimeve publike, përkatësisht të cilës i është përcaktuar pushimi i kryerjes së autorizimeve publike e humb cilësinë e personit juridik dhe shlyhet nga Regjistri Qendror.

## Shoqatat profesionale

### Neni 72

Për shkak të financimit të një ose më shumë veprimtarive të ngjashme të zejtarisë, kryerësit e veprimtarisë së zejtarisë anëtarë të odave të zejtarisë, të themeluara në formë të seksioneve në kuadër të një ose më shumë odave të zejtarisë mund të mblidhen vullnetarisht në shoqata profesionale në nivel të Republikës së Maqedonisë.

## Financimi i odave

### Neni 73

Oda e zejtarëve dhe Oda e zejtarëve e Republikës së Maqedonisë sigurojnë mjete për kryerjen e detyrave të tyre nga:

- kontributi i detyrueshëm i odës,
- kompensimi për shërbime të kryera nga autorizimet publike,
- kompensimet nga shërbimet tjera të parapara në statutin,
- donacionet dhe
- burimet tjera.

Kryerësit e veprimtarisë së zejtarisë që merren me veprimtari të zejtarisë të përcaktuara në listat e zejeve që janë në zhdukje lirohen nga pagesa e kontributit të odës.

Mjetet nga kontributi i odës kryerësit e veprimtarisë së zejtarisë janë të obliguar t'i paguajnë me këtë proporcion, dhe atë 10% për Odën e Zejtarëve të Republikës së Maqedonisë ndërsa 90% për odën e zejtarëve në të cikën është regjistruar.

Kompensimi për shërbimet e kryera nga autorizimet publike paguhet 10% për Odën e Zejtarëve të Republikës së Maqedonisë dhe 90% të odës së zejtarëve që e ka kryer shërbimin nga autorizimet publike.

Kompensimin për shërbimet e kryera nga autorizimet publike, e cakton Kuvendi i Odës së Zejtarëve të Republikës së Maqedonisë në bazë të shpenzimeve të bëra reale të nevojshme për lëshimin e aktvendimit dhe lejes së zejtarëve, pas pëlqimit të marrë paraprak nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

### Neni 74

Odat e zejtarëve me mjete financiare financojnë:

- realizimin e interesave të përbashkëta shoqërore, ekonomike dhe sociale të kryerësve të veprimtarisë së zejtarëve,
- përfaqësimin e interesave të anëtarëve të tyre,
- zhvillimin dhe avancimin e zejtarisë në kuadër të veprimit të lirë të ligjshmërive tregtare,
- vendosjen e regjistrimit elektronik të zejtarëve,
- realizimin e bashkëpunimit me organizatat dhe institucionet e njëjta ose të ngjashme në Republikën e Maqedonisë dhe jashtë vendit, për zhvillimin dhe promovimin e zejtarisë nacionale, nëpërmjet pjesëmarrjes në panaire, ekspozita dhe manifestime të ngjashme,
- detyrat dhe obligimet nga përfaqësimi i interesave të anëtarëve të tyre në procedurat e harmonizimit të legjislativit ekzistues ose miratimit të legjislativit të ri,
- informimin dhe këshillimin e përgjithshëm profesional të anëtarësisë,
- organizimin e trajnimeve, kualifikimeve, rikualifikimeve, kualifikimeve plotësuese me qëllim të përmirësimit të cilësisë së produkteve dhe shërbimeve të zejtarëve,
- aktivitetet individuale të këshillimit dhe ndihmën profesionale të anëtarëve me kërkesë të tyre të cilat si udhëzime të përgjithshme nuk kërkojnë angazhim të ekspertëve të caktuar nga sfera e caktuar, as që kërkojnë adaptim të materialeve të veçanta, në pajtim me parimet e organizatave këshilluese dhe
- nevoja tjera në pajtim me statutin dhe vendimet e Kuvendit.

## X. MBIKËQYRJA

### Neni 75

Mbikëqyrje të zbatimit të këtij ligji dhe rregullat e miratuara në bazë të këtij ligji kryen ministria kompetente për punët nga sfera e zejtarisë.

Punët e mbikëqyrjes inspektuese i kryen Inspektorati Shtetëror i Tregut, nëpërmjet inspektorëve shtetërorë të tregut, në pajtim me këtë dhe me ligj tjetër.

## Neni 76

Nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese përcaktohet se është kryer parregullsi nga neni 77 i këtij ligji, Inspektorati Shtetëror i Tregut është i obliguar të përpilojë procesverbal në të cilin do të përcaktohet parregullsia e kryer me sugjerim për mënjanim të parregullsisë së përcaktuar në afat prej tetë ditësh dhe me dorëzim të njëkohshëm të ftesës për zbatim të edukimit të personit ose subjektit ku është përcaktuar parregullsia gjatë kryerjes të mbikëqyrjes inspektuese.

Formën dhe përmbajtjen e ftesës për edukim, si dhe mënyrën e zbatimit të edukimit i përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e zejtarisë.

Edukimin e organizon dhe zbaton Inspektorati Shtetëror I Tregut, përkatësisht organi i cili e ka kryer mbikëqyrjen inspektuese në afat jo më të gjatë se tetë ditë nga dita e zbatimit të mbikëqyrjes inspektuese.

Edukimi mund të zbatohet për më shumë parregullsi të njëjta të përcaktuara për një ose për më shumë subjekte.

Nëse në terminin e caktuar personi ose subjekti për të cilin zbatohet edukimi nuk paraqitet në edukim do të konsiderohet se edukimi është i zbatuar.

Nëse personi ose subjekti për të cilin zbatohet edukimi paraqitet në edukimin e caktuar dhe të njëjtin e përfundon do të konsiderohet se është i edukuar në lidhje me parregullsinë e përcaktuar.

Nëse Inspektori Shtetëror i Tregut gjatë zbatimit të mbikëqyrjes kontrolluese përcakton se janë mënjeluar parregullsitë e konstatuara nga paragrafi 1 i këtij neni, miraton konkluzion me të cilin e ndërpret procedurën për mbikëqyrjen inspektuese.

Nëse Inspektori Shtetëror i Tregut gjatë zbatimit të mbikëqyrjes kontrolluese përcakton se nuk janë mënjeluar parregullsitë e përcaktuara nga paragrafi 1 i këtij neni, parashtron kërkesë për ngritje të procedurës për kundërvajtje në komisionin e kundërvajtjes të formuar në pajtim me Ligjin për inspektoratin shtetëror të tregut.

Inspektorati Shtetëror i Tregut mban evidencë për zbatimin e edukimit në mënyrë të përcaktuar nga ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e zejtarisë.

## XI. DISPOZITA TË KUNDËRVAJTJES

### Neni 77

Gjobë në shumë prej 500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje kryerësit të veprimtarisë zejtare, nëse:

- 1) e kryen veprimtarinë e tij jashtë lokaleve për punë dhe
- 2) në vend të dukshëm nuk e thekson orarin e tij të punës dhe nuk përmbahet në orarin e caktuar të punës.

Gjobë në shumë prej 30% nga gjoba e matur për kryerësin e veprimtarisë zejtare do t'i shqiptohet edhe personit përgjegjës te personi juridik dhe personit përgjegjës te tregtari individ për veprimet nga paragrafi 1 i këtij neni.

Gjobë në shumë prej 50 deri në 75 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet zejtarit për veprimet nga paragrafi 1 i këtij neni.

Për kundërvajtjet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, kryerësit do t'i shqiptohet urdhërpagesë e kundërvajtjes për pagesë të gjobës në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të urdhërpagesës së kundërvajtjes.

Nëse kryerësi i kundërvajtjes nuk e paguan gjobën në afatin nga paragrafi 4 i këtij neni inspektori shtetëror i tregut do të parashtrorë kërkesë për ngritje të procedurës për kundërvajtje te Komisioni për Kundërvajtje.

#### Neni 78

Gjobë në shumë prej 700 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje kryerësit të veprimtarisë zejtare, nëse:

- 1) nuk e paraqet plotësimin e kushteve minimale teknike dhe
- 2) nuk e paraqit ndryshimin e adresës të selisë së saj, si dhe numrin e lokaleve.

Gjobë në shumë prej 30% nga gjoba e matur për kryerësin e veprimtarisë zejtare do t'i shqiptohet edhe personit përgjegjës të personit juridik dhe personit përgjegjës të tregtarit individ për veprimet nga paragrafi 1 i këtij neni.

Gjobë në shumë prej 70 deri në 100 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet zejtarit për veprimet nga paragrafi 1 i këtij neni.

Për kundërvajtjet të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, kryerësit do t'i shqiptohet urdhërpagesë mandatore të kundërvajtjes për pagesë të gjobës në afat prej tetë ditësh nga dita e dorëzimit të urdhërpagesës mandatore.

Nëse kryerësi i kundërvajtjes në mënyrë vullnetare nuk e paguan gjobën në afatin nga paragrafi 4 i këtij neni, inspektori shtetëror i tregut urdhërpagesën mandatore do ta dorëzojë te organi kompetent për përmbarim të detyrueshëm, për përmbarimin e saj.

#### Neni 79

Gjobë në shumë prej 1.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje kryerësit të veprimtarisë zejtare, nëse:

1) në vend të dukshëm nuk e vendos listën e çmimeve të prodhimeve, përkatësisht shërbimeve të veta dhe

2) nuk posedon dokumentacion adekuat për mallrat dhe materialet e furnizuara.

Gjobë në shumë prej 30% nga gjoba e matur për kryerësin e veprimtarisë zejtare do t'i shqiptohet edhe personit përgjegjës te personi juridik dhe personit përgjegjës te tregtari individ për veprimet nga paragrafi 1 i këtij neni.

Gjobë në shumë prej 100 deri në 150 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet zejtarit për veprimet nga paragrafi 1 i këtij neni.

Për kundërvajtjet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, kryerësit do t'i shqiptohet urdhërpagesë mandatore për pagesë të gjobës në afat prej tetë ditësh nga dita e dorëzimit të urdhërpagesës mandatore.

Nëse kryerësi i kundërvajtjes në mënyrë vullnetare nuk e paguan gjobën në afatin nga paragrafi 4 i këtij neni, inspektori shtetëror i tregut urdhërpagesën mandatore do ta dorëzojë te organi kompetent për përmbarim të detyrueshëm, për përmbarimin e saj.

#### Neni 80

Gjobë në shumë prej 2.500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje kryerësit të veprimtarisë zejtare nëse:

- 1) kryen veprimtari zejtare pa qenë i regjistruar në regjistrin qendror dhe pa leje për zejtar;
- 2) kryen veprimtari zejtare edhe krahas mungesës të bartësit të veprimtarisë zejtare;
- 3) veprimtaria kryhet nga persona të cilët nuk i plotësojnë kushtet nga neni 35 paragrafi 1 dhe
- 4) kryen veprimtari zejtare e cila është e shënuar në lejen për zejtarë.

Gjobë në shumë prej 30% nga gjoba e matur për kryerësin e veprimtarisë zejtare do t'i shqiptohet edhe personit përgjegjës te personi juridik dhe personit përgjegjës te tregtari individ për veprimet nga paragrafi 1 i këtij neni.

Gjobë në shumë prej 250 deri në 375 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet zejtarit për veprimet nga paragrafi 1 i këtij neni.

Për kundërvajtjen nga paragrafi 1 i këtij neni shqiptohet edhe masë e veçantë për kundërvajtje marrje e lëndës në pajtim me Ligjin për kundërvajtje.

Për kundërvajtje të përcaktuar në këtë nen inspektori shtetëror i tregut është i obliguar t'i propozojë kryerësit të kundërvajtjes procedurë për barazim me dhënie të urdhërpagesës për kundërvajtje.

#### Neni 81

Procedura e kundërvajtjes pas kundërvajtjeve të parapara në këtë ligj nuk mund të ngrihet as të mbahet nëse kalojnë 24 muaj nga dita e kundërvajtjes së kryer.

#### Neni 82

Inspektorët shtetërorë të tregut janë të obliguar të mbajnë evidencë për urdhërpagesat e dhëna mandatore dhe urdhërpagesat për kundërvajtje dhe për rezultatin e procedurave të ngritura.

Në evidencën nga paragrafi 1 i këtij neni grumbullohen, përpunohen dhe ruhen këto të dhëna: emri dhe mbiemri, përkatësisht titulli i kryerësit të kundërvajtjes, vendbanimi, përkatësisht vendqëndrimi, selia, lloji i kundërvajtjes, numri i urdhërpagesës mandatore/kundërvajtëse e cila i lëshohet dhe rezultati nga procedura.

Të dhënat personale nga paragrafi 2 i këtij neni ruhen pesë vjet nga dita e vendosjes në evidencë.

#### Neni 83

Formën dhe përmbajtjen të urdhërpagesës mandatore dhe urdhërpagesës për kundërvajtje i përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e zejtarisë.

#### Neni 84

Matja e lartësisë të gjobës për kryerësit e veprimtarisë zejtare kryhet në pajtim me Ligjin për kundërvajtje.

## XII. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

#### Neni 85

Rregullat e përcaktuara me këtë ligj do të miratohen në afat prej katër muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Deri në miratimin e rregullave nga paragrafi 1 i këtij neni do të zbatohen rregullat ekzistuese.

#### Neni 86

Odat ekzistuese të zejtarëve Shkup, Tetovë, Gostivar, Manastir, Ohër, Strumicë, Gjevgjeli, Kumanovë, Dibër, Vinicë, Shtip, Veles, Prilep, Resnjë dhe Strugë janë të obliguara ta harmonizojnë punën e tyre me dispozitat e këtij ligji në afat prej tetë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Nëse odat ekzistuese nga paragrafi 1 të këtij neni nuk e harmonizojnë punën e tyre me dispozitat e këtij ligji janë të obliguara në afat prej dy muajsh nga përfundimi i afatit nga paragrafi 1 i këtij neni t'i dorëzojnë të gjitha regjistrat e zejtarëve të Odës së Zejtarëve të Republikës së Maqedonisë.

Me ditën e dorëzimit të regjistrave nga paragrafi 2 i këtij neni shfuqizohen autorizimet publike të mara në bazë të Ligjit për ushtrim të veprimtarisë zejtare ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 62/2004, 55/2007, 115/10, 36/11, 53/11 dhe 164/13) ndërsa Ministria kompetente për punët nga sfera e zejtarisë me detyrë zyrtare në afat prej shtatë ditësh do të parashtrijë kërkesë te Regjistri qendror për shlyerje të Odave të Zejtarëve nga paragrafi 1 i këtij neni.

#### Neni 87

Oda e Zejtarëve e Republikës së Maqedonisë është e obliguar ta harmonizojë punën e dispozitave të këtij ligji në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Oda e Zejtarëve e Republikës së Maqedonisë në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji është e obliguar të miratojë statut të odës në pajtim me këtë ligj.

Oda e Zejtarëve e Republikës së Maqedonisë është e obliguar në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji të vendos regjistër elektronik të zejtarëve.

#### Neni 88

Oda e Zejtarëve fillon me kryerje të autorizimeve publike në pajtim me këtë ligj nga dita e hyrjes në fuqi të aktvendimit për kryerje të autorizimeve publike të miratuara në pajtim me këtë ligj nga ministria e cila udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e zejtarisë.

#### Neni 89

Kryerja e autorizimeve publike për regjistrim në Regjistrin e zejtarëve, dhënia e lejes për zejtar, dhënia e aktvendimit për regjistrim të ndryshimit në Regjistrin e zejtarëve, dhënia e aktvendimi për ndalim të përkohshëm të ushtrimit të veprimtarisë, dhënia e aktvendimit për çlajmërim të veprimtarisë dhe dhënia e aktvendimit për kryerje të përkohshme të veprimtarisë zeytare në pajtim me dispozitat e këtij ligji do të fillojnë të zbatohen në afat prej tetë muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Deri në fillim të kryerjes së autorizimeve publike nga paragrafi 1 të këtij neni, regjistrimi i veprimtarisë në regjistrin e zejtarëve, dhënia e aktvendimit për kryerje të veprimtarisë zeytare, ndryshimi në regjistrin e zejtarëve, ndërprerja e ushtrimit të veprimtarisë zeytare, ndalimi i përkohshëm i veprimtarisë, shlyerja e regjistrimit në regjistrin e zejtarëve, do të bëhet në pajtim me Ligjin për kryerje të veprimtarisë zeytare ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 62/2004, 55/2007, 115/10, 36/11, 53/11, 164/13 dhe 129/15).

#### Neni 90

Procedurat e filluara për regjistrim të veprimtarisë në regjistrin e zejtarëve, ndryshimi në regjistrin e zejtarëve, dhënia e aktvendimit për kryerje të veprimtarisë zeytare, ndërprerja e ushtrimit të veprimtarisë zeytare, ndalimi i përkohshëm i veprimtarisë dhe shlyerja e regjistrimit në regjistrin e zeytareve deri në ditën e fillimit të kryerjes së autorizimeve publike në pajtim me nenin 89 paragrafi 1 të këtij ligji do të përfundojnë në pajtim me Ligjin për kryerje të veprimtarisë zeytare ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 62/2004, 55/2007, 115/10, 36/11, 53/11, 164/13 dhe 129/15).

#### Neni 91

Zejtarët të cilët janë të regjistruar në Regjistrin e zejtarëve dhe të gjithë kryerësit e veprimtarisë zeytare të cilët janë të evidentuar në evidencën e kryerësve të veprimtarisë zeytare të cilët deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji ushtrojnë veprimtari zeytare, janë të obliguar në afat prej 24 muajve nga dita e fillimit të zbatimit të kryerjes së autorizimeve publike nga neni 89 paragrafi 1 të këtij ligji ta harmonizojnë punën e tyre me dispozitat e këtij ligji dhe të parashtrajnë kërkesë të dhoma e zejtarëve për dhënie të aktvendim për kryerje të veprimtarisë zeytare dhe lejes për zejtar.

Nëse zejtarët të cilët janë të regjistruar në Regjistrin e zejtarëve dhe të gjithë kryerësit e veprimtarisë zeytare të cilët janë të evidentuar në evidencën e kryerësve të veprimtarisë zeytare nuk e harmonizojnë punën e tyre në afatin e përcaktuar nga paragrafi 1 të këtij neni do të shlyhen nga Regjistri i zejtarëve dhe nga evidenca e kryerësve të veprimtarisë zeytare.

#### Neni 92

Aktvendimet për regjistrim në Regjistrin e zejtarëve dhe Aktvendimet për kryerje të veprimtarisë zejtare të cilat u janë dhënë zejtarëve në pajtim me Ligjin për kryerje të veprimtarisë zejtare ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 62/2004, 55/2007, 115/10, 36/11, 53/11, 164/13 dhe 129/15) deri në dhënie të aktvendimit për kryerje të veprimtarisë zejtare dhe lejes për zejtar në pajtim me nenin 89 paragrafi 1 të këtij ligji, vazhdojnë të zbatohen.

#### Neni 93

Regjistri qendror në bazë të kërkesës të Odës së Zejtarëve të Republikës së Maqedonisë, në pajtim me Ligjin për Regjistrin qendror, do t'i mundësojë Odës së Zejtarëve të Republikës së Maqedonisë t'i ndërmarr të dhënat për tregtarët të regjistruar individual, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar nga një person i cili ushtron veprimtari zejtare dhe do t'i regjistrojë në Regjistrin e zejtarëve në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

#### Neni 94

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Ligji për kryerje të veprimtarisë zejtare ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 62/2004, 55/2007, 115/10, 36/11, 53/11, 164/13 dhe 129/15) përveç dispozitave të neneve 14, 14-a, 17, 23, 26, 27, 27-a, 28 të cilat do të vazhdojnë të zbatohen tetë muaj nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

#### Neni 95

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".